

## MISIONI NDËRKOMBËTAR I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE

### Zgjedhjet për Kuvendin, Republika e Shqipërisë – 3 korrik 2005

---

#### DEKLARATË E KONSTATIMEVE DHE PËRFUNDIMEVE PARAPRAKE

**Tiranë, më 4 korrik 2005** – Me ftesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR-i) dërgoi Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) në Shqipëri më 18 maj 2005. Për vëzhgimin e procedurave në ditën e zgjedhjeve, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it bashkoi përpjekjet me vëzhgues nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së (AP e OSBE-së), Asambleja Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), si dhe Parlamenti Evropian (PE). Ata vlerësuan përputhshmërinë e procesit zgjedhor me legjislacionin shqiptar, Angazhimet e OSBE-së, si dhe angazhimet e Këshillit të Evropës dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

Kjo deklaratë e konstatimeve dhe konkluzioneve paraprake nxirret para përfundimit të numërimit të votave në të 100 qendrat e numërimit, skadimit të afateve ligjore për shqyrtimin e apelimeve të mundshme në lidhje me votimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultateve, si dhe vendosjes në detyrë të zyrtarëve të zgjedhur. Një vlerësim përfundimtar mbi të gjithë procesin zgjedhor do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i këtyre fazave të mbetura të procesit.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it do të qendrojë në Shqipëri për të vazhduar vëzhgimin dhe mund të nxjerrë komente publike shtesë, sipas nevojës. OSBE/ODIHR-i do të publikojë një Raport Përfundimtar, duke përfshirë një analizë të hollësishme të të gjitha konstatimeve të vëzhguesve si dhe rekomandime vijuese, rreth gjashtë javë pas përfundimit të procesit.

#### Përfundime Paraprake

Zhvillimi i zgjedhjeve për Kuvendin të datës 3 korrik 2005 gjatë periudhës parazgjedhore, votimit dhe numërimit, deri tani, kanë qenë në përputhje, vetëm pjesërisht, me disa nga Angazhimet e OSBE-së, angazhimet e Këshillit të Evropës dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Megjithëse këto ishin përgjithësisht zgjedhje konkurruese dhe media në përgjithësi u dha zgjedhësve një larmishmëri informacioni zgjedhor, parti politike kryesore duhet që ende të tregojnë vullnet dhe përgjegjësi politike në raport të barabartë me autoritetin e gjerë që u është dhënë mbi procesin zgjedhor.

Mosveprimi i vazhdueshëm i autoriteteve shqiptare për futjen e një sistemi uniform të adresave të ndërtesave si dhe të dokumenteve të reja personale të identifikimit në mbarë vendin zvogëloi domethënien e përpjekjeve të ndërmarra për përmirësimin e listave të zgjedhësve. Çështjet janë me rëndësi thelbësore dhe zgjidhja e tyre kërkon angazhim të menjëhershëm dhe të pakushtëzuar.

Mungesa e besimit midis partive politike çoi në vonesa për arritjen e një marrëveshjeje për kuadrin zgjedhor, si dhe ndikoi negativisht në përgatitjet dhe zhvillimin e zgjedhjeve. Duke patur parasysh zgjedhje të ardhshme, përmirësime të mëtejshme të kuadrit zgjedhor do të kërkonin vëmendje urgjente dhe përpjekje më përfshirëse.

Dispozitat e Kodit Zgjedhor që detajojnë sistemin zgjedhor nuk sigurojnë realizimin e objektivit kushtetues për të arritur një proporcionalitet “në raport sa më të afërt” midis votave të marra nga listat e partive dhe përbërjes së përgjithshme të Kuvendit. Ky sistem lejoi shumë pjesëmarrës në zgjedhje të përdornin strategji zgjedhore që sfiduan caqet e ligjit dhe venitën dallimet midis partive politike. Pas përvojës së zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2001, procesi zgjedhor i vitit 2005 konfirmon se sistemi zgjedhor aktual do të mbetet i hapur ndaj abuzimeve derisa të reformohet.

Zhvillimet e mëposhtme pozitive kanë karakterizuar procesin zgjedhor deri tani:

- Një spektër i gjerë partish dhe kandidatësh u regjistruan, në të shumtën e rasteve pa pengesa, për të konkurruar në zgjedhje, dhe u ofruan zgjedhësve një shumëllojshmëri zgjedhjeje;
- Partitë ishin aktive në zhvillimin e fushatave të tyre zgjedhore dhe u zotuan se do të zbatonin Kodin e Sjelljes, i cili luajti rol të rëndësishëm në vendosjen e standardeve të fushatës;
- Pasqyrimi në media i periudhës zyrtare të fushatës ishte përgjithësisht i mjaftueshëm dhe i barazpeshuar politikisht për t’u dhënë mundësi pjesës më të madhe të partive, në të gjithë spektrin politik, të përçojnë mesazhet e tyre;
- Ndryshimet në legjislacionin zgjedhor, të miratuara nga një shumicë e gjerë në Kuvend, paraqitën një sërë përmirësimesh;
- Në shumicën e rasteve, KQZ-ja e administroi procesin në mënyrë transparente, profesionale dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor;
- Përpjekje të konsiderueshme dhe relativisht të suksesshme, ndonëse të vonuara, nga autoritete shtetërore dhe ato të qeverisjes vendore prezantuan një kuadër të ri për regjistrimin e zgjedhësve duke siguruar qartësi në ndarjen e përgjegjësive të organeve të përfshira, që, në shumë zona zgjedhore, rezultoi në një saktësi të përmirësuar të listave të zgjedhësve;
- Kolegji Zgjedhor e përmbushi detyrimin e tij për të vendosur për ankesa parazgjedhore kundrejt vendimeve të KQZ-së në mënyrë të drejtë dhe të paanshme;
- Megjithëse çështjeve që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare iu dha një konsideratë më e madhe nga disa kandidatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për përmirësimin e regjistrimit të zgjedhësve të popullsive minoritare, në veçanti në komunitetin rrom.

Gjithsesi, mbeten disa çështje për t’u trajtuar, duke përfshirë sa më poshtë:

- Ndërkohë që parti politike kryesore gëzojnë autoritet shumë të madh mbi administrimin e zgjedhjeve ato duhet ende të tregojnë një shkallë përgjegjësie në të njëjtën masë;
- Një numër i konsiderueshëm pretendimesh, disa prej të cilave të provuara, për ndërhyrje në të drejtën e shtetasve për lirinë e të shprehurit dhe për përfshirje në veprimtari politike, përfshirë rastin e nëpunësve civilë që u është bërë presion të mbështesin ose të mos bëhen pjesë e mbështetjes për një kandidat apo një parti të caktuar;
- Vendime administrative nga kryetari i një njësie bashkiake të Tiranës dhe zyrtarë të universitetit që çuan në mohim të mundshëm të ushtrimit të së drejtës së një numri të konsiderueshëm të studentëve për të votuar në vendin ku studiojnë;
- Asnjë përmirësim në pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në çështje publike;

- Ka një numër të lartë zgjedhësish, të cilëve nuk mund t'u përcaktohej vendndodhja gjatë procesit të verifikimit (të ashtuquajturit rekordet '999' në listat e zgjedhësve). E lidhur me probleme që kanë të bëjnë me identifikimin e zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve, në veçanti me lëshimin dhe përdorimin e çertifikatave të lindjes, këto ndezën frikën për abuzim të mundshëm, të tillë si përvetësimin e identitetit të zgjedhësve me një adresë numerike të paplotë;
- Ndërkohë që u pastruan një numër i ndjeshëm i rekordeve të shumëfishta në listat e zgjedhësve nga institucionet përgjegjëse brenda një kohe të shkurtër, nevojitet përpjekje e mëtejshme me qëllim trajtimin e rekordeve të shumëfishta të mbetura, veçanërisht kur janë në njësi të ndryshme të qeverisjes vendore si dhe drejtshkrimin e emrave të zgjedhësve.
- Zhvillimi i votimit në ditën e zgjedhjeve tregoi vetëm process të kufizuar në krahasim me zgjedhje të mëparshme. Në shumë raste, KQV-të nuk patën vlerësim të mjaftueshëm për procedura korrekte, në veçanti në lidhje me përdorimin e bojës për shmangien e votimit të shumëfishtë, fshehtësinë e votës dhe kontrollimin e identitetit të zgjedhësit. Megjithëse disa zgjedhës u kthyen mbrapsht nga qendrat e votimit për shkak se emrat e tyre nuk ishin në listat e zgjedhësve, kjo ishte shumë më e rrallë se gjatë zgjedhjeve të mëparshme. Ndërkohë që votimi u zhvillua në një atmosferë përgjithësisht paqësore, disa incidente të dhunshme, duke përfshirë një rast fatal, njollosën procesin.

## **Konstatime Paraprake**

### **Historik**

Zgjedhjet për Kuvendin të datës 3 korrik 2005 ishin të gjashtat që janë zhvilluar që nga vendosja e sistemit shumëpartiak në Shqipëri në vitin 1991. Në vitin 2001, Partia Socialiste (PS), e udhëhequr nga Kryeministri Fatos Nano, mori shumicën e vendeve. Së bashku me deputetë nga katër parti të tjera: Partia Social Demokrate (PSD), Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNj), Partia Aleanca Demokratike (PAD) dhe Partia Agrare (PA), si dhe deputetë të zgjedhur si kandidatë të pavarur, PS-ja formoi një qeveri koalicioni. Opozita përbëhej nga Partia Demokratike (PD) e udhëhequr nga Dr. Sali Berisha, dhe pesë parti të tjera.

Të gjitha partitë e mëdha kandiduan në zgjedhjet e vitit 2005 ose si koalicion ose veçmas. Këtu përfshihen partitë e lartpërmendura dhe një parti e re, Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), e udhëhequr nga ish-Kryeministri Ilir Meta, i cili bashkë me tetë deputetë të tjerë të zgjedhur nën PS-në u shkëputën nga partia qeverisëse në vitin 2004. Që nga viti 2004, Partia Lëvizja e Legalitetit hyri në aleancë me Partinë Demokratike të Rinovuar.

Që prej vitit 1991, rivaliteti midis dy partive më të mëdha, PS-së dhe PD-së, ka qenë i fortë dhe antagonist. Në të shkuarën, gjatë dhe pas zgjedhjeve, disa parti, veçanërisht ato në opozitë, kanë shprehur mungesë besimi në integritetin e procesit zgjedhor. Dy zgjedhjet e fundit u tejkëqatën, u shënuan nga pasiguri dhe pjesë të zgjedhjeve duhej të përsëriteshin për shkak të parregullsive.

### **Sistemi Zgjedhor**

Kushtetuta parashikon parimet e mëposhtme në lidhje me sistemin zgjedhor:

- Një numër fiks mandatesh për Kuvendin (140), ku 100 deputetë (71%) zgjidhen drejtpërdrejtë në zona njëemërore dhe 40 (29%) zgjidhen nga listat e partive ose koalicioneve të partive.
- Se “numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie [...] duhet të jetë në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në shkallë vendi [...]”.
- Se partitë duhet të marrin të paktën 2.5 për qind të votave të vlefshme dhe koalicionet e partive duhet të marrin të paktën 4 për qind të votave të vlefshme për të marrë pjesë në shpërndarjen e 40 mandateve ‘shtesë’.

Në vitin 2003, Kuvendi miratoi Kodin Zgjedhor, që zhvilloi më tej një sistem zgjedhor të ndërlikuar. Neni 67 i Kodit Zgjedhor përpiqet të respektojë nenin 64.2 të Kushtetutës dhe parashikon që 40 mandatet shtesë të shpërndahen në mënyrë të tillë që pjesa e partive në numrin e përgjithshëm të deputetëve (140) t’i afrohet ‘në raport sa më të afërt’ përqindjes së votave të marra nga listat e tyre shumëemërore.

Megjithatë, Kodi Zgjedhor nuk arrin të sigurojë zbatimin e dispozitave kushtetuese që parashikojnë si objektiv proporcionalitetin në përbërjen e Kuvendit. Mbështetur në të drejtën e zgjedhësve për të patur dy vota të veçanta, partitë mund t’i anashkalojnë dispozitat e përcaktuara për realizimin e objektivit kushtetues të proporcionalitetit nëpërmjet zhvillimit të strategjive duke u bërë thirrje zgjedhësve të ndajnë dy votat e tyre me partitë që janë në koalicion formal ose joformal ta. Këto strategji kanë potencialin të ulin shkallën e mundshme të proporcionalitetit dhe mund të rezultojnë në më pak mandate për partitë që nuk janë përfshirë në strategji. Megjithëse strategji të tilla mund të jenë brenda ligjit, ato venitin identitetet politike dhe ulin transparencën. Pavarësisht nga fakti se në zgjedhjet e vitit 2001, përpjekjet për të luajtur me sistemin zgjedhor kishin ndodhur tashmë, dispozitat ligjore mbi shpërndarjen e mandateve shtesë mbetën në një pjesë të madhe të pandryshuara.

Si përvoja e procesit zgjedhor të vitit 2001, ashtu edhe ajo e vitit 2005 priren të tregojnë se sistemi zgjedhor që është në fuqi aktualisht do të mbetet i hapur ndaj abuzimeve derisa të reformohet.

### **Kuadri ligjor**

Kodi Zgjedhor u miratua në qershor 2003. Pavarësisht nga mangësitë serioze të vërejtura më sipër si dhe shqetësimet ende të patrajtuara të ngritura nga Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës dhe OSBE/ODIHR-i në Rekomandimet e tyre të Përbashkëta në vitin 2004, legjislacioni mund të sigurojë një bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike nëse ekziston gatishmëria nga autoritetet publike dhe partitë politike për zbatimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor në besim të mirë.

Kodi Zgjedhor u ndryshua në tri raste të veçuara në vitin 2004 dhe 2005. Këto ndryshime, shumica e të cilave trajtuan disa prej Rekomandimeve të Përbashkëta, sollën një sërë ndryshimesh, në veçanti në lidhje me administratën zgjedhore, hartimin e listave të zgjedhësve, kriteret për ndarjen e zonave zgjedhore, procedurat e numërimit, si dhe procedurat për ankesat dhe apelimet. Këto ndryshime u bënë gjerësisht nëpërmjet një procesi bipartizan.

Sidoqoftë, ende mbeten disa mangësi, në disa raste në kundërshtim me standarde ndërkombëtare. Kodi nuk arrin të sigurojë transparencë dhe siguri në shpërndarjen e mandateve për listat shumëemërore të partive. Në zgjedhjet e vitit 2005, disa parti paraqitën në KQZ marrëveshje të brendshme të partisë për ndryshimin e renditjes të përfituesve të mandateve sipas kriterëve të

përcaktuara nga vetë partitë<sup>1</sup>. Gjithashtu, disa dispozita në Kod diskriminojnë parti politike ‘të vogla’. Kjo është e vërtetë, në veçanti, në fushën e reklamave politike me pagesë në median elektronike private, ku Kodi u jep partive ‘më të mëdha të drejtën për të blerë “dyfishin e minutazhit” të partive ‘më të vogla’.

Më tej, në fund të vitit 2004 u miratua legjislacioni për ndarjen e re të 100 zonave zgjedhore. Zonat e reja zgjedhore, që ishin fryt i një marrëveshjeje politike midis PS-së dhe PD-së, parashikohen në një ligj të veçantë që u miratua dhe hyri në fuqi në mars 2005. Megjithëse zgjidhja e arritur është një përmirësim krahasuar me kufijtë e mëparshëm, ajo nuk përmbush plotësisht kërkesat e ligjit në një numër zonash.

### **Administrata Zgjedhore**

Zgjedhjet për Kuvendin administrohen nga një administratë zgjedhore me tri nivele: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), 100 Komisione të Zonave Zgjedhore (KZZ), dhe 4 764 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Në vijim të një marrëveshjeje të arritur në tetor 2004, ‘balancimi politik’ i KQZ-së u ndryshua me ‘dorëzimin’ e një vendi nga shumica parlamentare për opozitën. KQZ-ja emëroi nga shtatë anëtarë për çdo KZZ, në bazë të propozimeve nga gjashtë parti politike të përcaktuara; tre nga secila anë e spektrit politik. PS-ja dhe PD-ja propozuan kryetarë për KZZ në mënyrë të barabartë. KQV-të dhe grupet e numërimit u emëruan me përbërje identike me KZZ-të. Nëpërmjet propozimeve të tyre për anëtarë në organet e administratës zgjedhore në të gjitha nivelet, partitë politike ushtruan ndikim të konsiderueshëm mbi procesin zgjedhor. Partitë politike janë në të vërtetë pothuajse plotësisht përgjegjëse për funksionimin e administratës zgjedhore.

KQZ-ja ka zhvilluar takime deri në dy herë në ditë. Deri para ditës së zgjedhjeve, ajo mori mbi 1000 vendime dhe miratoi rreth 20 udhëzime. Këto duken se u përmbaheshin standardeve profesionale dhe qenë në përgjithësi në përputhje me Kodin Zgjedhor. Mbledhjet e KQZ-së, në shumicën e rasteve, u zhvilluan në mënyrë profesionale, kolegjinale dhe transparente. Përfaqësuesit e partive qenë të pranishëm dhe propozimet e tyre u dëgjuan në mënyrë të drejtë. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it nuk vëzhgoi ndonjë anësi politike pro apo kundër ndonjë subjekti zgjedhor në procesin e vendimmarrjes. Megjithatë, hera-herës diskutimet u tejzgjatën dhe vendime të rëndësishme u vonuan disa herë. Gjithsesi, këta faktorë nuk patën një ndikim të ndjeshëm negativ në përgatitjet zgjedhore të KQZ-së. KQZ-ja u përball me disa sfida logjistike dhe administrative në organizimin e këtyre zgjedhjeve. Detyra e saj u ndërlikua nga mungesa e bashkëpunimit të plotë nga disa autoritete të qeverisjes vendore dhe KQZ-së iu desh të gjobiste disa kryetarë të njësisve të qeverisjes vendore që nuk respektuan afatet për dorëzimin e informacioneve të rëndësishme.

Për të çertifikuar rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, për të shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve ose për të marrë vendime mbi ankesat kundër vendimeve të KZZ-së në lidhje me rezultatin e zgjedhjeve, në KQZ kërkohet një vendim i pesë prej shtatë anëtarëve të saj. Kështu, ekziston mundësia që KQZ-ja të mos jetë në gjendje të miratojë rezultatin e zgjedhjeve. Një vlerësim përfundimtar në lidhje me administrimin e zgjedhjeve nga KQZ-ja do të jetë i mundur vetëm pas nxjerrjes dhe shpalljes së rezultateve si dhe gjykimin e ankesave dhe apelimeve në lidhje me ditën e zgjedhjeve si dhe ndonjë ankesë apo apelim pas ditës së zgjedhjeve.

---

<sup>1</sup> Siç është vërejtur tashmë nga Rekomandimet e Përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias në vitin 2004, deri në atë shkallë që [ligji] të lejojë një ndryshim në renditje ose një renditje “përfundimtare” të kandidatëve pasi zgjedhësi të ketë hedhur votën, [ai] do të jetë në kundërshtim me Angazhimet e OSBE-së dhe standarde ndërkombëtare.

Sipas ligjit, të gjitha KZZ-të duhej të ngriheshin deri në 3 mars 2005, por, meqë kufijtë e zonave zgjedhore nuk ishin përcaktuar përfundimisht deri në atë datë, KQZ-ja vendosi të shtyjë mbledhjen e parë të KZZ-së deri më 16 maj, për t'u dhënë partive kohë për të propozuar anëtarë. Megjithatë, disa parti politike, në veçanti ato në opozitë, nuk i propozuan të gjithë anëtarët deri në këtë datë. Për rrjedhojë, vetëm 63 KZZ u formuan në kohë. Në fillim, partitë shfrytëzuan gjerësisht të drejtën për të zëvendësuar anëtarë. Kjo zvogëloi qendrueshmërinë në përbërjen e KZZ-së. KQZ-ja zhvilloi trajnime për KZZ-të dhe përgatiti materiale trajnimi për KQV-të dhe grupet e numërimit.

Të paktën gjysma e kryetarëve të KZZ-ve kanë shërbyer në KZZ në zgjedhje të mëparshme. Megjithëse kjo përvojë mund të ketë ndihmuar në administrimin e zgjedhjeve, një pakicë domethënëse e KZZ-ve nuk kishin burime të mjaftueshme materiale dhe shumica raportuan se nuk kishin marrë fonde operative në kohë. Emërimi i KQV-ve ishte një sfidë madhore për KZZ-të dhe disa prej tyre patën vështirësi në përfundimin e emërimeve në kohë. Disa parti politike u shprehën se i vonuan propozimet e tyre nga frika se këta anëtarë të KQV-ve mund të korruptoheshin. Kjo e ndërlikoi trajnimin e disa KQV-ve.

### **Listat e Zgjedhësve**

Legjislacioni që rregullon procesin e regjistrimit të zgjedhësve u reformua në një numër hapash gjatë periudhës tetor 2004 - janar 2005. Përgjegjësia për hartimin dhe mirëmbajtjen e listave të zgjedhësve u transferua nga KQZ-ja tek autoritetet e qeverisjes vendore, dhe listat u hartuan në bazë të regjistrave të gjendjes civile. Në fillim, u zhvillua një verifikim derë më derë që synonte përditësimin e regjistrave të gjendjes civile dhe caktimin e një 'adrese numerike' dhjetë shifrore për shtetasit. Ky sistem i ri ishte një zhvillim i mirëpritur, por koha dhe burimet në dispozicion të njësive të qeverisjes vendore për të hartuar dhe kompjuterizuar listat e zgjedhësve ishin të pakta. Më tej, u identifikuan shpesh gabime në drejtshkrimin e emrave të zgjedhësve.

Një bazë të dhënash me listat e zgjedhësve në shkallë vendi u krijua mbështetur në listat e zgjedhësve nga njësitë e qeverisjes vendore dhe u administrua nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit (MPVD), që ka përgjegjësi të identifikojë probleme specifike, në veçanti rekorde të mundshme të shumëfishta dhe të informojë njësitë e qeverisjes vendore në lidhje me to me qëllim që këto të fundit të ndërmarrin veprimet për t'i zgjidhur.

Pavarësisht nga disa mangësi, u bë një përpjekje domethënëse dhe shumë herë e suksesshme për të përmirësuar saktësinë e listave të zgjedhësve. Në listat përfundimtare të zgjedhësve u regjistruan si zgjedhës 2,85 milionë shtetas. Megjithatë, në listat përfundimtare mbetën rreth 470 000 rekorde që nuk kishin një adresë të plotë numerike (të ashtuquajturat 'rekordet 999'). Këto rekorde përkojnë me persona që nuk qe e mundur të kontaktoheshin gjatë procesit të verifikimit. Problemi u vërejt në veçanti në zonat urbane. Një numër i panjohur i këtyre personave mund të ketë migruar brenda ose jashtë Shqipërisë.

Sipas ligjit, listat paraprake duhej të bëheshin publike që nga data 1 prill deri në 3 maj. MPVD-ja e shtyu dy herë afatin e datës 3 maj, duke e shtuar kohën në dispozicion të publikut për të kontrolluar listat dhe për të kërkuar përfshirjen e tyre nëse emri i tyre nuk ishte në listë. Një fushatë informimi publik në shkallë të gjerë u zhvillua për të informuar shtetasit mbi të drejtat dhe detyrat e tyre përsa i takon regjistrimit të zgjedhësve. Pas datës 8 qershor, kur listat e zgjedhësve u përfunduan, personat që nuk e kishin emrin në lista, mund të votonin vetëm me një vendim nga gjykata e rrethit.

MPVD-ja identifikoi rreth 200 000 rekorde të mundshme të shumëfishta në listat paraprake të zgjedhësve, që përkonin me rreth 100 000 shtetas të regjistruar. Deri më 8 qershor, rekordet për mbi 80 000 shtetas ishin zgjidhur në mënyrë të tillë që këta shtetas të ishin të regjistruar vetëm një herë. Partive politike iu dha mundësia të analizonin listat përfundimtare të zgjedhësve. Dy ditë para ditës së zgjedhjeve, PD-ja i dha MVZ-së lista me rekorde të shumëfishta të mbetura.

Listat e zgjedhësve mbetën një çështje polemike gjatë periudhës parazgjedhore. Pjesa më e madhe e vëzhguesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it raportuan pozitivisht në lidhje me saktësinë e listave, pavarësisht nga shqetësimet për: numrin e lartë të rekordeve '999'; një përjasje jo e njëtrajtshe në shpërndarjen e këtyre rekordeve në qendra votimi nga njësitë e qeverisjes vendore; mosrespektimi i afateve ligjore për bërjen publike të listave përfundimtare të zgjedhësve, vonesë në përcjelljen për partitë politike të të dhënave të plota të regjistrimit të zgjedhësve dhe pothuajse 16% e qendrave të votimit që tejkalojnë numrin 1 000 të zgjedhësve të regjistruar – maksimumi ligjor. Vëzhguesit raportuan se pak zgjedhës i kontrolluan emrat e tyre në listat përfundimtare të zgjedhësve, dhe akoma më pak kërkuan një vendim gjykate për të mundësuar përfshirjen e tyre në listë në ditën e zgjedhjeve.

Probleme domethënëse me listat e zgjedhësve u vërejtën në rreth 17 zona, duke përfshirë zonat 5 dhe 6 (Shkodër), 25 dhe 28 (Durrës). Në zonën 33 (Tiranë) nuk u ndërmor ndonjë veprim për një numër të madh kërkesash nga shtetas me të drejtë vote për shtesa në lista. Gjithashtu, në të njëjtën zonë, si dhe në zonën 38 (Tiranë) ekzistojnë shqetësime serioze në lidhje me mohimin e mundshëm të së drejtës së studentëve për të votuar. Kjo shtoi akuzat se lista e zgjedhësve në zonat 33 dhe 38 po manipuloheshin politikisht. Vendime administrative, që paraqesin pengesa për zgjedhësit me të drejtë vote ta ushtrojnë këtë të drejtë në mënyrë efikase, bien në kundërshtim me procese demokratike.

Në fazën e vonë të periudhës para zgjedhore, u ngrit një polemikë në lidhje me përdorimin e certifikatave të lindjes<sup>2</sup> si dokument identifikimi në qendrat e votimit, në kontekstin e një mungese të vazhdueshme të dokumenteve të reja të identitetit për përdorim të brendshëm dhe një sistemi uniform adresash. Zakonisht, certifikatat e lindjes lëshohen lehtësisht. Megjithatë, vëzhguesit raportuan se, si praktikë, shumë prej njërive të qeverisjes vendore nuk kanë mbajtur shënim certifikatat e lëshuara. Ky fakt, i ndërthurur me vjedhjen e një numri domethënës të certifikatave të paplotësuar dhe printimin e paligjshëm të pretenduar si dhe shpërndarjen e një numri madje edhe më të madh të tyre, ngritën shqetësime tek palët e interesuara se certifikatat do të keqpërdreshin për të shfrytëzuar mangësitë në listat e zgjedhësve. Megjithatë, përdorimi i rregullt i bojës në gishtin e zgjedhësve pati potencialin të zvogëlonte votimin e mundshëm të shumëfishtë. Megjithatë, kjo nuk trajton probleme të mundshme të përvetësimit të identitetit të zgjedhësve me adresë numerike të paplotë.

## **Regjistrimi i partive dhe kandidatëve**

Partive joparlamentare iu kërkua të paraqisnin 7 000 nënshkrime për të regjistruar listën e tyre partiake. Shtatëmbëdhjetë parti joparlamentare paraqitën listat e tyre. Sidoqoftë, megjithëse ligji

---

<sup>2</sup> Certifikatë lindjeje është një kopje e rekordeve të lindjes nga regjistri i zyrës së gjendjes civile, që lëshohet nga autoritetet vendore dhe është e vlefshme për tre muaj. Nëse përdoret për qëllime të përdorimit të brendshëm, duhet të ketë një fotografi në faqen e përparme dhe një pullë takse në faqen e pasme. Si fotografia edhe pulla e taksës duhen duhen vulosur me vulën e Zyrës së Gjendjes Civile të njësisë së qeverisjes vendore. Një vulë e dytë personale e nëpunësit civil përkatës kërkohet në pullë.

i jep KQZ-së kohë të pamjaftueshme për të verifikuar listat e nënshkrimeve, përjasja e KQZ-së për regjistrimin e partive nuk ishte e njëtrajtshme. Kjo ishte pjesërisht për arsye se Kodi Zgjedhor nuk rregullon mjaftueshëm çështjen dhe pjesërisht për arsye se KQZ-ja nuk miratoi një vendim që të përvijojë përjasjen e saj. KQZ-ja nuk pranoi 13 lista partish, duke regjistruar katër të tjerat. Në rastin e Lidhjes së Blertë, KQZ-ja pranoi deklarata të noterizuara të nënshkuara nga shtetasit në emër të anëtarëve të tjerë të familjes, megjithëse një praktikë e tillë nuk parashikohet në Kodin Zgjedhor. Pesë parti fituan apelin kundër vendimit të KQZ-së për të mos pranuar listat e tyre.

Partive parlamentare dhe kandidatëve të tyre në zonat zgjedhore nuk u kërkohet të paraqesin nënshkrime. Listat e 17 partive parlamentare u regjistruan nga KQZ-ja. Këto përfshinin Partinë e Ballit Kombëtar dhe Partinë e Sigurisë Kombëtare, ku secila prej tyre paraqiti një deklaratë nga një deputet aktual se ishte anëtar i asaj partie. Megjithatë, të dy deputetët kandiduan për parti të tjera në zgjedhje dhe dokumentacioni i dërguar nga Kuvendi në KQZ mbi disa çështje të tjera nuk rendiste asnjërin prej këtyre partive të kishte ndonjë përfaqësues në Kuvend.

KQZ-ja regjistroi 27 lista zgjedhore. 18 parti kandiduan veçmas, u krijuan dy koalicion me lista të përbashkëta, përfshirë Lëvizjen Për Zhvillim Kombëtar– Leka Zog (LZhK) dhe një koalicion shtatëpartiak ‘Aleanca për Drejtësi, Liri dhe Mirëqenie (ADLM), përbërësit e të cilit u paraqitën veçmas në fletën e votimit. Shumë parti kanë vendosur të mos u bashkëngjisin listave të tyre, para zgjedhjeve, rendin e shpërndarjes së mandateve që mund të fitojnë. Këto do të shpërndahen sipas formulave që marrin parasysh rezultatin zgjedhor të listës në zona.

Mbi 1 200 kandidatë do të konkurrojnë në 100 zona njëemërore. KQZ-ja la në fuqi shatë prej gjashtëmbëdhjetë apeliemeve kundër vendimeve të KZZ-ve për të mos pranuar kandidatë. Kandidatët vijnë nga 31 parti. Gjithashtu, në zonat njëemërore do të konkurrojnë 11 kandidatë të pavarur. Në mënyrë të dukshme, partitë në koalicionin ADLM nuk kanë propozuar asnjë kandidat nën siglën e tyre.

Partia Socialiste (PS) qeverisëse i regjistroi kandidatët dhe listën partiake në maxhoritarin parlamentar veçmas nga aleatët e saj. Këto pesë parti konkurrojnë gjithashtu si subjekte zgjedhore të ndara si në shkallë zone zgjedhore ashtu edhe në shkallë vendi. Asnjë marrëveshje zyrtare koalicioni midis partive qeverisëse nuk është miratuar. Në mënyrë të përsëritur, përgjatë kohës që MVZ-ja ka qenë në vend, PS-ja ka deklaruar se nuk do të përdorë strategji për të ndikuar në shpërndarjen e mandateve shtesë në favor të aleatëve të tyre politikë. Megjithatë, PS-ja informoi gjithashtu MVZ-në se ajo nuk e përjashtonte mundësinë që marrëveshje politike të mund të lidheshin në nivel lokal. Vëzhgues të MVZ-së raportuan për thirrje të përsëritura, në disa vende, nga parti aleate të PS-së për të votuar për kandidatët e PS-së në maxhoritar në zonë.<sup>3</sup> Thirrje të ngjashme janë vëzhguar në median elektronike.

PD-ja arriti marrëveshje të shkruara me shtatë partitë e koalicionit ADLM, dhe për rrjedhojë PD-ja dhe këto parti regjistruan një kandidat të vetëm në secilën zonë në emër të PD-së. Kështu, formalisht, PD-ja ka 100 kandidatë në zonat njëemërore, siç kërkohet nga ligji. Megjithatë, me ftesë të PD-së, pesëmbëdhjetë prej këtyre kandidatëve ishin *de facto* të propozuar nga aleatët e PD-së. PD-ja dhe ADLM-ja regjistruan lista të veçanta dhe nxitën mbështetësit e tyre të votojnë për listat e ADLM-së në vend të listës shumerërore të PD-së. Vlen të përmendet se lista e Partisë Republikane, anëtare e ADLM-së, përmban emrat e 30 anëtarëve të PD-së duke përfshirë edhe deputetë të zgjedhur si kandidatë për PD-në në legjislaturën që u mbyll.

---

<sup>3</sup> Për shembull në Fier, Korçë, Himarë, dhe Tiranë



Është shqetësues fakti që strategjitë e lartpërmendura duket se shfrytëzojnë mangësi në Kodin Zgjedhor për të maksimizuar numrin e mandateve shtesë si për aleatët e PS-së ashtu edhe të PD-së, mund të keqpërfaqësojnë lidhjen politike të kandidatëve dhe, për rrjedhojë, mund të çorientojnë zgjedhësit. Strategji të tilla mund të zvogëlojnë besimin e zgjedhësve në aftësinë e sistemit zgjedhor për t'i përkthyer zgjedhjet e tyre elektorale në mandate sipas parimeve të parashikuara në Kushtetutë.

## **Çështje Gjinore**

Në Kushtetutën shqiptare garantohen të drejta të barabarta për burrat dhe gratë. Megjithatë, në Shqipëri, gratë janë të nënperfaqësuara ndjeshëm në jetën publike. Për më tepër, përfaqësimi i grave dhe pjesëmarrja e tyre në procesin zgjedhor nuk është përmirësuar me kalimin e kohës. Nuk është ndërmarrë asnjë nismë domethënëse për të rritur numrin e grave të emëruara dhe të zgjedhura në poste vendimmarrëse. Nga 38 parti që konkurrojnë në zgjedhje, drejtuesja e vetëm njëjës prej tyre, Lidhja e Blertë Shqiptare, është grua. Në legjislaturën që u mbyll, vetëm 6,4% të deputetëve ishin gra, ndjeshëm më pak se në vitin 1991 ku shifra përkuese ishte 20,5%.

Statutet e dy partive kryesore përmbajnë kuota për kandidatë femra; 25 % në PD dhe 20% në PS. Megjithatë, të dyja partitë i zbatuan klauzolat në një mënyrë të tillë që nuk ka të ngjarë të çojnë në zgjedhjen e një numri më të madh grash deputete. Në zonat zgjedhore njëemërore, PS-ja ka propozuar tetë gra ndërsa PD-ja vetëm tre. Të dyja partitë propozuan gra në listat e tyre partiake në numra më të lartë, por strategjitë e tyre politike d.m.th. nxitja e mbështetësve të partisë për të hedhur votën jo për listën e tyre, por për aleatët e tyre politikë, mund të ketë zvogëluar mundësinë zgjedhore për kandidatët e tyre. Për rrjedhojë, zgjedhjet e vitit 2005 mund të jenë një tjetër mundësi e humbur për të rritur numrin e grave pjesëmarrëse në nivelet më të larta të jetës publike.

Mungesa e barazpeshës gjinore e pranishme edhe në nivelin e mesëm të administratës publike është shqetësim serioz. Gjashtë parti politike kanë të drejtën ligjore për të propozuar anëtarë për KZZ dhe KQV, megjithatë vetëm katër prej 100 kryetarëve të komisioneve të zonave zgjedhore janë gra dhe vetëm rreth 16% e kryetarëve të KQV-ve janë gra.

## **Pjesëmarrja e pakicave kombëtare**

Regjistrimi i popullsisë dhe i banesave i vitit 2001 nuk përfshiu pyetjen në lidhje me etnicitetin e të pyeturve. Për rrjedhojë, ka një mungesë të të dhënave zyrtare aktuale të besueshme mbi pakicat kombëtare. Megjithatë, komunitetet greqishtfolëse banojnë në disa zona në jug të Shqipërisë dhe komunitete rrome dhe egjiptiane banojnë në qytete e fshatra të ndryshme të vendit. Pakica të tjera përfshijnë arumunët (vllehët), maqedonasit dhe serbo-malazezët, ku këto dy të fundit banojnë në zona të përqendruara në komuna të veçanta.

Në vitin 2004, qeveria miratoi ngritjen e një Komiteti të Posaçëm Shtetëror për Pakicat, i ngarkuar me dhënien e rekomandimeve për promovimin e të drejtave të disa pakicave. Pozicioni i disa pakicave është përmirësuar, pjesërisht nëpërmjet nismave të tyre për të krijuar apo zhvilluar shoqata politike si dhe përpjekjeve për mbrojtje të të drejtave tyre. Megjithatë, pengesa mbeten akoma përsa i përket pjesëmarrjes së plotë të pakicave rrome dhe egjiptiane në procesin zgjedhor dhe ka patur pak progres në lidhje me regjistrimin e tyre si zgjedhës. Vëzhgues kanë marrë pretendime të besueshme se janë bërë përpjekje për të ndikuar zgjedhjet e tyre elektorale në disa komuna, këto pretendime i referoheshin presionit, blerjes së votës dhe korrupsionit.

Tradicionalisht, PBDNJ-ja ka kërkuar mbështetje politike të popullsisë minoritare. Në vitin 2005, kjo parti propozoi një numër të lartë kandidatësh nga rradhët e popullsisë minoritare, megjithëse pjesa më e madhe vinin nga pakica greke. Në fushatën e vet zgjedhore, PBDNJ-ja i kushtoi pak vëmendje çështjeve të pakicave. Lëvizja për të Drejtat dhe Lirinë e Njeriut ishte e vetmja parti, platforma e së cilës përfshinte thirrje për zbatimin e të drejtave të pakicave. MVZ-ja vërejti se PD-ja komentoi mbi problemet sociale që hasin popullsia rrome dhe egjiptiane gjatë fushatës së tyre. Megjithatë, në prgjithësi, media i kushtoi pak vëmendje pjesëmarrjes së pakicave në zgjedhje. Në disa zona zgjedhore, materiale fushate në greqisht dhe maqedonisht u panë nga vëzhguesit. Megjithëse KQZ-ja bëri disa reklama informuese publike në gjuhët e pakicave në median lokale (greqisht, maqedonisht dhe serbisht), materialet zgjedhore, duke përfshirë fletët e votimit, u printuan vetëm në shqip.

### **Fushata dhe Mjedisi Parazgjedhor**

Në përgjithësi, fushata ishte tepër e dukshme dhe u organizua një numër i madh veprimtarish për fushatën. Ndërkohë që fushatat e PS-së dhe PD-së ishin më të fuqishme, edhe LSI-ja ishte aktive. Fushatat e PBDNJ-së, LZHK-së dhe PR-së duket se janë përqendruar në zona zgjedhore të veçanta. Vëzhguesit raportuan se, në përgjithësi, fushatat e ADLM-së dhe partive më të vogla të krahut të majtë ishin më pak aktive dhe patën një profil më të ulët. Me raste, ADLM-ja dhe PD-ja kanë organizuar veprimtari të përbashkëta fushate, ashtu si edhe kandidatët e PS-së me kandidatë nga partitë në koalicionin qeverisës. Partitë raportuan se kandidatët kanë zhvilluar fushatë derë më derë. Në media u zhvilluan disa debate midis kandidatëve. Në përgjithësi, fushata i dha elektoratit një vëllim të madh informacioni politik.

Para fillimit të fushatës zyrtare, gjashtëmbëdhjetë parti politike ranë dakord të nënshkruanin Kodin e Sjelljes të iniciuar nga Presidenti i Republikës, z. Alfred Moisiu. Nënshkruesit i janë përmbajtur në një shkallë të madhe Kodit të Sjelljes. Disa herë toni i fushatës ishte i hidhur. Megjithatë, në krahasim me zgjedhje të mëparshme, kandidatët dhe partitë i kushtuan më shumë kohë promovimit të platformave të tyre politike krahasuar me procese zgjedhore të mëparshme. Megjithatë, shumë prej reklamave me pagesë në media, në veçanti nga partitë më të mëdha parlamentare përmbanin sulme të drejtpërdrejta mbi rivalët e tyre dhe një shkallë të lartë 'fushate negative'. Megjithëse më pak e përhapur se në zgjedhje të mëparshme, akte dhune njollosën fushatën.<sup>4</sup>

Megjithëse të drejtat e lirisë së fjalës, e organizimit dhe tubimeve paqësore u respektuan në përgjithësi, vëzhguesit morën shumë pretendime dhe raporte për mangësi serioze gjatë periudhës së fushatës, disa prej të cilave sfiduan këto të drejta. Vlen të përmenden:

- Pretendime të shumta se disa nëpunësve publikë, sidomos në nivel lokal, u është bërë presion të merrnin pjesë në veprimtari të fushatës, të mbështesin një kandidat apo një parti të caktuar ose të mos mbështesin një kandidat apo parti.<sup>5</sup>
- Pretendime u bënë se studentëve po u bëhej presion për të mbështetur zyrtarë të universiteteve që kandidojnë në Tiranë dhe Korçë. Gjithashtu, u morën raporte të besueshme

---

<sup>4</sup> Për shembull në Durrës (ZZ28), ku një mbështetës i PD-së pretendohet se është sulmuar nga kandidati i PS-së, apo në Shijak (ZZ26), ku mbështetësit e PS-së hynë me forcë në një ndërtesë private dhe sulmuan banorët e saj sepse kishin vendosur postera të opozitës. Zyrrat e partive u vandalizuan në Fier, Korçë, Laç, Shkodër dhe Tiranë.

<sup>5</sup> Për shembull në Delvinë, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Përmet dhe Tiranë.

në lidhje me faktin se fëmijë të shkollave janë sjellë në mitingje fushatash nga mësuesit e tyre<sup>6</sup>.

- Në rreth 12 zona zgjedhore, vëzhguesit morën pretendime, disa prej të cilave të besueshme, se policia intimidoi shtetasit në lidhje me zgjedhjet e tyre elektorale apo veprimtarinë politike, ose nuk reagoi ndaj shkeljeve të rregullave të fushatës apo përpjekjeve për të intimiduar zgjedhësit<sup>7</sup>.
- Në pothuajse një të katërtën e zonave zgjedhore, vëzhguesit morën pretendime se shtetasit morën ose u ishin ofruar, dhurata ose para për të mbështetur një kandidat të caktuar;
- Vëzhguesit morën pretendime se burime shtetërore po keqpërodreshin me qëllim përfitimin e fushatës së partisë në pothuajse gjysmën e zonave zgjedhore dhe se personeli i shërbimit publik po mbështesnin fushatat e kandidatëve;<sup>8</sup> dhe,
- Prishjet me urdhër nga autoritetet vendore të ndërtesave, që pretendohet se ishin të paligjshme, duke përfshirë një zyrë të LSI-së në Tiranë dhe një shtëpi që i përkiste Kryetarit të Bashkisë së Sarandës para se pronarët/banorët të kishin mundësi të paraqisnin rastin e tyre për apelim në gjykatën e rrethit, ishin shumë shqetësuese.

Vlen të përmendet se pjesa më e madhe e akuzave pretendojnë se shkeljet janë bërë për të favorizuar PS-në. Megjithëse nuk ishte e mundur që vëzhguesit të verifikonin saktësinë e të gjitha pretendimeve, vëzhguesit konstatuan se shumë prej tyre ishin të besueshme dhe disa u verifikuan si të sakta. Shkelje të tilla do të ishin në kundërshtim me paragrafin 7.7 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së.

## Media

Kodi Zgjedhor rregullon pasqyrimin në media të çështjeve politike gjatë periudhës zyrtare të fushatës prej 30 ditësh. Nga media publike sigurohet minutazh falas. Medias private dhe publike i kërkohet të pasqyrojë fushatat e partive sipas forcës së tyre relative në legjislaturën që mbyllet. Gjatë fushatës zyrtare, media elektronike u monitorua nga Bordi i Monitorimit të Medias (BMM), që i raporton KQZ-së. Pavarësisht nga disa mangësi metodike dhe procedurale, përgjithësisht ai e kreu mandatin e tij me sukses. Megjithatë, operacione zyrtare monitorimi ‘në nivel lokal’ ishin në përgjithësi më pak efektive dhe shumë nuk u ngritën në kohë.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it analizoi përmbajtjen e medias kryesore elektronike dhe të shtypur që nga 18 maji deri në 2 qershor (para fillimit të periudhës zyrtare të fushatës) dhe nga 3 qershori deri në 3 korrik.<sup>9</sup> Gjatë fazës së parë, TVSH-ja, e cila finançohet në një masë të madhe nga buxheti i shtetit, pasqyroi në mënyrë favorizuese qeverinë gjatë pasqyrimin të lajmeve. Para fillimit të periudhës zyrtare të fushatës, lajmet kryesore të të gjitha mediave elektronike të monitoruara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it i dhanë qeverisë, PS-së dhe PD-së rreth 65% të kohës së kushtuar për çështje politike.

Pas fillimit të periudhës zyrtare të fushatës, pasqyrimi në lajmet e TVSH-së për PS-në dhe PD-në ishte më i barazpeshuar. PD-ja mori 19% të kohës së kushtuar subjekteve politike ndërkohë që PS-ja mori 16% (duke përfshirë pasqyrimin e veprimtarisë së zyrtarëve të qeverisë të përfshirë në veprimtari të fushatës). PS-ja dhe PD-ja morën përgjithësisht kohë të barabartë në transmetimin e

---

<sup>6</sup> Për shembull, në Berat, Elbasan, Fier dhe Lezhë.

<sup>7</sup> Për shembull në Gramsh, Kukës, Lezhë, Tiranë dhe Durrës.

<sup>8</sup> Për shembull në Durrës, Sarandë, Mallakastër, Shkodër dhe Tiranë.

<sup>9</sup> MVZ-ja monitoroi tri stacione televizive: *TVSH*, *TV Arbëria*, *TV Klan* midis orës 18.00 dhe 00.00 çdo ditë, dhe edicionin kryesor të lajmeve të Top Channel-it. Gjithashtu, u monitorua përmbajtja e gjashtë gazetave: *Shekulli*, *Panorama*, *Korrieri*, *Gazeta Shqiptare*, *Tema* dhe *Koha Jonë*.

lajmeve të kanaleve private të monitoruar nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it<sup>10</sup>. Megjithatë, të gjitha mediat dhanë një sasi disproporcionale të lartë të kohës së transmetimit për ‘dy partitë e mëdha’ parlamentare krahasuar me partitë ‘më të vogla’ parlamentare. Kështu, ata nuk iu përmbajtën dispozitave ligjore, që kërkojnë që sasia e përgjithshme e kohës së dhënë për secilën parti të ‘madhe’ parlamentare duhet të jetë “dyfishi i kohës së transmetimit” të dhënë për secilën nga partitë e ‘vogla’ parlamentare. Monitoruesit vërejtën gjithashtu pabarazi midis partive të vogla. Disa morën në mënyrë të konsiderueshme më pak pasqyrim se të tjerët. Më pozitivisht, monitoruesit konstatuan se, në përgjithësi, media raportoi politikisht mbi partitë në mënyrë neutrale gjatë transmetimit të lajmeve.

Media elektronike private shpesh transmetoi debate midis kandidatëve, duke rritur kështu llojin dhe sasinë e informacionit në dispozicion të zgjedhësve. Megjithatë, këto programe kishin prirje të ofronin një forum për katër parti politike (PS, PD, LSI dhe LZHK). Disa televizione lokale gjithashtu transmetuan forume me kandidatët. PS-ja pati numrin më të madh të reklamave me pagesë në median e monitoruar, megjithëse PD-ja dhe LSI-ja gjithashtu kanë vendosur reklama në një numër të madh. MVZ-ja nuk është në dijeni të ndonjë pretendimi se partive u janë ofruar kushte të favorshme krahasuar me parti rivale. Gjatë hapësirës së reklamave me pagesë, partitë u prirën të paraqesin rivalët e tyre në aspekte negative më tepër se të promovonin meritat e tyre. Në përgjithësi, media e shkruar ofroi një larmi pikpamjesh, megjithëse disa gazeta shfaqën qartazi politika editoriale partiake. Në median e shkruar në tërësi, gara midis PS-së dhe PD-së ishte mbizotëruese.

### **Zgjidhja e mosmarrveshjeve zgjedhore**

Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit të Tiranës vendos për ankesat kundër vendimeve të KQZ-së. Kolegji Zgjedhor, përbëhet nga tetë gjyqtarë me përzgjedhje rastësore nga një grup gjyqtarësh që gëzojnë këtë të drejtë. Ai vendos mbi çështjet me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë. Edhe trupat gjykues zgjidhen me llotari. Tridhjetë e katër apelime të vendimeve të KQZ-së u depozituan në Kolegjin Zgjedhor. Kolegji Zgjedhor la në fuqi 19 vendime të KQZ-së, rrëzoi 9 vendime dhe ktheu 2 në KQZ për shqyrtim të mëtejshëm. Pesë apelime të suksesshme kishin të bënin me vendime të KQZ-së për të mos regjistruar listat shumëmemërore të partive. Tre apelime të suksesshme kishin të bënin me regjistrimin e kandidatëve të pavarur në zonat zgjedhore njëmemërore. Një apel i suksesshëm kishte të bënte me një vendim të KQZ-së.

Vëzhguesit ndoqën pjesën më të madhe të rasteve të shqyrtuara në Kolegjin Zgjedhor. Asnjë anësi politike nuk ishte e dukshme gjatë seancave apo në vendime. Të gjitha palëve iu dha një mundësi a barabartë për të paraqitur pretendimet dhe në disa raste iu dhanë shtyrje të afatit me qëllim sigurimin e provave relevante. Në përgjithësi, para zgjedhjeve, Gjykata përmbushi detyrimin e saj për të marrë vendime me drejtësi dhe paanësi. Megjithatë, asaj mund t’i kërkohet që të marrë vendime në lidhje me ditën e zgjedhjeve dhe për të vendosur mbi apelimet përse i takon vendimeve të KQZ-së për rezultatin e zgjedhjeve. MVZ-ja do të vëzhgojë këto raste duke i kushtuar vëmendje nga afër mënyrës se si Kolegji përmbush detyrimin e tij ligjor sipas nenit 174/1 të Kodit Zgjedhor për të dhënë vendimet me shkrim të arsyetuara.

Vendimi i Kryetarit të Njësisë Bashkiake 2 në Tiranë, për të mos regjistruar 1 422 studentë në Universitetet e Tiranës meriton të përmendet në veçanti. Për rrjedhojë, këtyre studentëve nuk iu dha mundësia të votojnë në Tiranë, megjithëse ishte e drejta e tyre e ligjshme. Duke qenë se

---

<sup>10</sup> *TV Arbëria* i dha PD-së 27% të minutazhit politik në lajme dhe 26% PS-së. *TV Klan* 27% për PD-në dhe 29% për PS-në. *Top Channel* 28% për PD-në dhe 24% për PS-në. Të dhënat për PS-në përfshijnë pasqyrimin e anëtarëve të qeverisë të përfshirë në veprimtari të fushatës.

zyrtarët e univeristeteve vendosën të kryeshin provime ditën e zgjedhjeve, studentëve në të vërtetë iu mohua e drejta për të votuar. Pesë prej studentëve apeluan vendimin e Kryetarit të Njesisë Bashkiake në Gjykatën e Rrethit në Tiranë. Më pas, PD-ja i paraqiti një kërkesë KQZ-së për të vendosur sanskione mbi Kryetarin e Njesisë Bashkiake. Më 9 qershor, gjykata vendosi në favour të studentëve. Megjithatë, ajo urdhëroi vetëm regjistrimin e pesë studentëve që kishin paraqitur një apel. Edhe këta persona nuk u përfshinë në listë pasi listat përfundimtare të zgjedhësve ishin shtypur tashmë. Është tepër problematike që këta studentë u hoqën nga lista e zgjedhësve, jo për faj të tyre, por për shkak të veprimeve të autoriteteve qeveritare. KQZ-ja gjobiti kryetarin e njesisë bashkiake me 80 000 LEK (rreth 670 Euro) për veprimet e tij që u mohuan këtyre zgjedhësve të drejtën e votës. Një sanskion i tillë duket të jetë i pamjaftueshëm për shkeljen dhe mund të parandalojë ndjekje penale të kryetarit të njesisë bashkiake.

## Dita e Zgjedhjeve

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht paqësore. Megjithatë disa incidente të dhunshme njollosën procesin, duke përfshirë një gjuajtje fatale me armë në afërsi të një qendre votimi (QV) në zonën 37 në Tiranë dhe veprimtari të personave të armatosur në zonën 65. Incidente të tjera të dukshme u raportuan në zonat 25 dhe 26, që shkaktuan ndërprerje në procesin e vëzhgimit, dhe zonat 38, 63, dhe 79. Partitë paraqitën pretendime se incidente të dhunshme ndodhën në zonat 4, 10, dhe 34. Vëzhguesit raportuan 14 incidente të dhunshme në QV.

Pavarësisht nga atmosfera nganjëherë e tensionuar (11% e QV-ve të vizituara), anëtarët e shumicës më të madhe të KQV-ve (96%) bashkëpunuan mirë me njeri-tjetrin për zhvillimin e votimit. Në shumicën dërrmuese të rasteve, policia respektoi detyrimet e saj ligjore për të qendruar jashtë qendrave të votimit. Megjithatë, persona të pa autorizuar ndërhyjnë në proces në 4% të QV-ve të vizituara.

Ndërkohë që vëzhguesit morën një numër relativisht të lartë pretendimesh për parregullsi serioze nga disa lokalitete, duke përfshirë pretendime për blerjen e votës, disa u vërtetuan ose u vëzhguan drejtpërdrejtë. Pjesa më e madhe e ankesave me shkrim të marra nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it erdhën nga PS-ja dhe LSI-ja. Ankesa zyrtare u paraqitën në 6% të QV-ve. Vëzhguesit u informuan se rreth 700 familje nuk paten mundësi të merrnin pjesë në zgjedhje, për shkak të praktikës së vazhduar të gjakmarrjes tradicionale. Në shumë pak lokalitete, vëzhguesit morën pretendime se çertifikata lindjeje të paplotësuara ishin lëshuar në mënyrë të paligjshme.

Një numër i konsiderueshëm qendrash votimi nuk u hapën në kohë, në veçanti në zonën 26 dhe në zonën 2, ku mjaft të tilla nuk arritën të hapeshin fare. Ndërprerje të votimit u raportuan në 8% të QV-ve të vizituara dhe rradha të mëdha në rreth 9%. Mundësia e hyrjes në qendrat e votimit ishte e vështirë në 14% të qendrave të votimit, që mund të kishte ndikuar në votimin e shtetasve me aftësi të kufizuar. Megjithatë, dispozitat që lejonin personat me aftësi të kufizuar shikimi të votonin pa asistencë ishin një risi e mirëpritur.

Vëzhguesit raportuan se zgjedhës u kthyen mbrapsht nga 51% e qendrave të votimit të vizituara pasi emrat e tyre nuk figuronin në lista. Megjithëse kjo shifër duket e lartë, në një shumicë dërrmuese të rasteve problemi duket se preku relativisht pak zgjedhës dhe ndodhi shumë më rrallë se në zgjedhje të mëparshme. Aty ku ndodhi ky problem, shumë KQV i drejtuan shtetasit në pikat e informimit në KZZ për të kontrolluar nëse ishin të regjistruar gjetkë. Megjithatë, rastet e pakta të ekzistencës së mospërputhjeve midis listës përfundimtare të afishuar në QV dhe listës së zgjedhësve dhënë KQV-ve, përbëjnë shqetësim. Vëzhguesit raportuan raste të izoluara ku një numër i vogël zgjedhësish nuk u lejuan të votojnë për shkak të gabimeve ortografike në emrat e

tyre. Shumica e KQV-ve ishin në dijeni të vendimit të KQZ-së të miratuar me vonesë për të mbajtur certifikatat e lindjes. Në shumë raste, zgjedhësve, të cilët nuk mund ta vërtetonin identitetin e tyre me një dokument të dytë, ose certifikata e lindjes e të cilëve kishte skaduar, iu mohua votimi, derisa të paraqisnin dokumente të tjera identiteti.

Megjithëse disa procedura në përgjithësi u respektuan, të tilla si vulosja e duhur e kutive të votimit, nuk ndodhi kështu me të tjera. Konkretisht, vëzhguesit vërejtën se disa KQV, sidomos në zonat rurale, nuk kontrolluan si duhet identitetin (6%), rrallë ose asnjëherë nuk u kontrollua boja (19%), ose nuk u praktikua boja (11%), duke zvogëluar efektshmërinë e elementëve të sigurisë për të shmangur votmin e shumëfishtë. Zgjedhësit nuk nënshkruan dhe emrave të tyre nuk iu vu vizë në listat e zgjedhësve në 5% të QV-ve. Kjo mund të ketë ndërlikuar përputhshmërinë në numrin e fletëve të votimit me nënshkrimet në një fazë të mëvonshme të procesit. Fshehtësia e votës nuk u respektua njaftueshëm në 13% të QV-ve. Megjithëse i ashtuquajtur “votim familjar” ndodhi më rrallë se në zgjedhje të mëparshme (vëzhguar në 10% të QV-ve), mbetet një problem i vazhdueshëm dhe serioz, sidomos në zonat rurale. Emërimi me vonesë nga ana e partive politike i anëtarëve të KQV-ve solli që këta anëtarë të humbisnin trajnimin dhe mund të ketë kontribuar në mungesën e dukshme të njohjes me procedurat. Këta faktorë patën një efekt negativ mbi vlerësimin e përgjithshëm të procesit nga ana e vëzhguesve. Në përgjithësi, votimi u vlerësua më pak pozitivisht në prefekturat në veri të vendit (Shkodër, Lezhë, Kukës, dhe Dibër) dhe në jug të vendit (Vlorë dhe Gjirokastër), në krahasim me vende të tjera. Në përgjithësi, vëzhguesit e konsideruan negativisht procesin në 11% të qendrave të vizituara dhe pozitivisht në 67% të tyre.

Në përgjithësi, QV-të u mbyllën në kohë dhe vëzhguesit raportuan se ata që ishin duke pritur në rradhë patën mundësi të hidhnin votën e tyre. Procedurat e mbylljes u respektuan në një masë të madhe. Megjithatë, kopje të procesverbaleve të votimit, nuk iu dhanë sistematikisht atyre që gëzonin të drejtën për t'i marrë.

### **Numërimi i votave**

Në KZZ, disa kuti votimi u vlerësuan të ‘parregullta’ dhe për rrjedhojë do të kërkohet hetim nga KQZ-ja (31 raste të raportuara). Me raste, këto kuti votimi nuk u izoluan dhe nuk u siguruan siç e kërkon ligji. Disa qendra numërimi (QN) ishin vendosur në mjedise të përshtatshme, por vëzhguesit raportuan se hapësira ishte e pamjaftueshme në rreth një të katërtën e qendrave të numërimit të vëzhguara. Fatkeqësisht, një grup vëzhguesish (në rrethin e Lezhës) u përzu nga qendra e numërimit. Gjatë marrjes së materialeve zgjedhore, vëzhguesit raportuan një atmosferë të tensionuar në 29% të QN-ve dhe dy incidente të dhunshme. Organizimi i marrjes së materialeve u vlerësua i dobët në nëntë qendra numërimi. Trajnimi i grupeve të numërimit, që filloi në një fazë shumë të vonë të procesit për shkak të afatit të vonë të emërimit dhe në disa raste për shkak të mbërritjes së vonë të anëtarëve të grupeve të numërimit, ishte shpesh i pamjaftueshëm.

Vëzhguesit e MVZ-së kanë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme procesin e dorëzimit të materialit zgjedhor në qendrat e numërimit dhe nxjerrjen e rezultateve në 82 zona zgjedhore. Në të gjitha qendrat e numërimit të vëzhguara, ashtu siç parashikohet në ligj, numërimi i votave filloi vetëm pasi të gjitha qendrat e votimit kishin dorëzuar kutitë e votimit. Komente shtesë mbi procesin e numërimit do të bëhen në çastin e duhur.

## **Vëzhgimi vendorë**

Numri relativisht i lartë i vëzhguesve nga organizata të shoqërisë civile përfshirë Komitetin Shqiptar Kundër Korrupsionit dhe Këshillin Rinor Shqiptar si dhe përbërjen shumëpartiake të KQV-ve ndihmuan për të siguruar transparencën e procesit. Vëzhguesit vendorë jopartiakë u identifikuan qartë nga vëzhguesit e MVZ-së në 28% të QV-ve. Vëzhguesit e MVZ-së raportuan se vëzhguesit e partive ishin të pranishëm në 94% të QV-ve të vizituara dhe në 95% të QN-ve.

---

*Kjo deklaratë gjendet edhe në shqip.  
Megjithatë, versioni në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.*

---

## **Informacion për Misionin & Falenderime**

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) i OSBCE/ODIHR-it u hap në Tiranë më 18 maj 2005 me 40 ekspertë dhe vëzhgues afatgjatë të vendosur në kryeqytet dhe në 11 qendra rajonale. Në ditën e zgjedhjeve, 408 u dërguan vëzhgues afat-shkurtër nga 36 vende pjesëmarrëse në OSBE, përfshirë 23 parlamentarë nga Asambleja Parlamentare e OBCE-së, 20 nga APKE dhe 9 nga Parlamenti Evropian. MNVZ-ja vëzhgoi procesin e votimit dhe numërimin në mbi 1 200 qendra votimi në mbarë vendin dhe 82 qendra votimi pas mbylljes së qendrave të votimit, për të vëzhguar hedhjen e rezultateve.

Ambasadori Andreas Notelle (Gjermani) bashkërendoi Delegacionin e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (AP). Z. Jerzy Smoravinski (Poloni), anëtar i Senatit polka, drejtoi Delegacionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE). Zj. Doris Pack (Gjermani), deputete e Parlamentit Evropian, drejtoi Delegacionin e Parlamentit Evropian (PE). Z. Jørgen Grunnet (Danimarkë) kryesoi Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it.

MVZ-ja dëshiron të falenderojë Ministrinë e Punëve të Jashtme për ftesën e bërë për të vëzhguar zgjedhjet, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për dhënien e dokumenteve të akreditimit dhe autoritete të tjera kombëtare dhe lokale për ndihmesën dhe bashkëpunimin e tyre. MVZ-ja dëshiron gjithashtu të shprehë vlerësim për Prezencën e OSBE-së në Shqipëri për mbështetjen e tyre gjatë kohëzgjatjes së misionit, Misioneve të OSBE-së në Kosovë dhe Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për personelin e dërguar për të shërbyer si vëzhgues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it, dhe Ambasadave të Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së në Tiranë.

Për informacione të mëtejshme, jeni të lutur të kontaktoni:

- Z. Jørgen Grunnet, Kryetar i MVZ-së së OSBE/ODIHR-it në Tiranë (Tel: +355 4 234 221, 234 213 );
- Zj. Urdur Gunnarsdottir, Zëdhënëse e OSBE/ODIHR-it ose z. Gilles Saphy, Këshiltar për Zgjedhjet i OSBE/ODIHR-it, në Varshavë (Tel: +48-22-520-06-00);
- Z. Vladimir Dronov, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në Strazburg (Tel: +33-388-41-20-00);
- Zj. Katherine Volz, Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, zyra e Vienës (Tel: +43 1 52 33 002);
- Zj. Sabina Mazzi-Zissis, Parlamenti Evropian në Bruksel (Tel: +32 2 284 21 11);

### **Adresa e OSBE/ODIHR-it:**

OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights, Al. Ujazdowskie 19, 00-557 WARSAW, POLAND  
Tel: +48-22-520-06-00 [www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr)